



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 21.1.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË ZYRËS SË
KRYEMINISTRIT TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2010**

Prishtinë, Maj 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i auditimit.....	6
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	6
IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e aprovuar.....	7
V. Pasqyrat Vjetore Financiare.....	8
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm.....	8
V.2 Cilësia e informatave	9
VI. Realizimi i Buxhetit.....	9
VI.1 Të hyrat.....	9
VI.2 Shpenzimet.....	10
VII. Menaxhimi i kontrollit.....	16
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	16
VII.2 Auditimi i Brendshëm.....	17
VIII. Konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e ZKM-së.....	18
Shtojca I. Komentet e ZKM-së dhe përgjigjja e ZAP-it.....	19
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	19

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
ABGJ	Agjencioni për Barazi Gjinore
AP	Auditori i Përgjithshëm
APP	Agjencia për Prokurim Publik
AUV	Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës
AIE	Agjencioni për Integritet Evropiane
AK	Arkivi i Kosovës
DT	Dosja e Tenderit
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MIE	Ministria e Integriteteve Evropiane
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizata Buxhetore
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare, më tutje (PVF) të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës më tutje (ZKM) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF-të.

Gjatë formimit të opinionit tonë kemi vlerësuar në përgjithësi saktësinë e prezantimit të informatave në PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të plotë dhe të drejtë. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

Megjithatë kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendësi të raportit.

ZKM nuk kishte arritur të siguroj një funksionim të mirë të kontrollit të brendshëm.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguron:

- Rishikimin dhe analizimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara; dhe
- Në kordinim me menaxherët e agjencive (AUV dhe ABGJ), të ndërmerni veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Për më tepër, ju nxisim të siguron:

- Informatat për pasuritë janë të sakta dhe të plota; dhe
- Janë ndërmarrë masa për aktivizimin e Komitetit të Auditimit.

Menaxhmenti i ZKM-së është pajtuar me të gjeturat dhe konkludimet tona në këtë raport, dhe është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e ZKM-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e ZKM-së të përgatisë PVF-të sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr.16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor të rregullsisë në institucionin tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të ZKM-së. Gjatë asaj faze kemi trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmetin për adresimin e çështjeve, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në Dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e ZKM-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e ZKM-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të e ZKM-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi PVF;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;

- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në ZKM.

Në raport, ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2010.

Lidhur me opinionin tonë për PVF-të e ZKM-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të plotë dhe të drejtë. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin tonë të auditimit të PVF 2009 janë dhënë rekomandime për (6) fusha kryesore.

Rekomandimet e vitit të kaluar ishin adresuar pjesërisht. Përkundër angazhimit të ZKM-së, çështjet brenda këtyre rekomandimeve të cilat ende nuk janë adresuar kanë të bëjnë me:

- Shtimin e aktiviteteve për menaxhimin dhe mbledhjen e të hyrave nga qiraja;
- Vlerësimin e ofertave dhe shpërblyesi i kontratës të ketë dosjen e tenderit të përgjegjshme me të gjitha kërkesat e parapara në dosjen e tenderit;
- Kontrollat më adekuate për t'u siguruar që procedurat përkatëse të prokurimit (kontraktimit) dhe realizimit janë zbatuar;
- Menaxhim efikas të pasurisë përkatësisht komisioni i regjistrimit të pasurisë të përfundoj dhe listoj të gjithë pasurinë sipas sasisë, vlerës dhe elementeve tjera të parapara në formularin e regjistrimit të pasurisë; dhe
- Sistemin i kontrollit të brendshëm rishikohet vazhdimisht nga menaxhmenti për të konfirmuar se është duke funksionuar siç kërkohet dhe është korrigjuar sipas nevojës për t'u adaptuar kërkesave të ndryshme.

Në rekomandimin e dhënë në lidhje me përmirësimin e bazës ligjore së AUV-së për të hyrat, kemi vërejtur se kjo është në fazën përfundimtare të përgatitjes së tij.

Konkluzion

Përkundër progresit, ne edhe më tutje shprehim shqetësimin tonë lidhur me faktin se si ZKM-ja i adreson rekomandimet tona. ZKM ende nuk ka arritur të siguroj kontrolle adekuate në menaxhimin financiar.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i përgjithshëm:

- Është duke i kushtuar me shumë vëmendje adresimit të rekomandimeve të dhëna, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar.

IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar 2010	Buxheti i shpenzuar 2009
Grandi i Qeverisë – Buxheti	8,829,589	8,376,505	8,575,245	7,819,286	7,438,592
Te Hyrat Vetanake	-	-	564,630	290,306	89,391
Donacionet e brendshme	-	-	554,983	353,131	490,215
Donacionet e jashtme			1,486,587	1,020,746	189,376
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	8,829,589	8,376,505	11,181,447	9,483,470	8,207,574
Rrogat dhe pagat	1,988,566	2,133,151	2,431,662	2,338,439	1,559,825
Mallra dhe shërbime	2,528,551	2,225,347	3,813,065	3,252,328	2,438,221
Shpenzimet komunale	197,290	200,847	173,814	119,837	88,747
Subvencionet dhe transferet	1,390,000	1,246,943	1,457,350	1,118,311	1,634,897
Investimet Kapitale	2,725,589	2,570,217	3,305,566	2,654,553	2,485,885
Rezervat					
II. Gjithsej shpenzimet	8,829,589	8,376,505	11,181,447	9,483,470	8,207,574

Shpenzimet e realizuara për vitin 2010 ishin 9,483,470€ apo 84% e buxhetit final.

Në tabelë vërehet se me rishikimin e buxhetit në mes të vitit, buxheti i ZKM-së është zvogluar. Kjo rrjedh si rezultat i shuarjes së Agjencionit për Integritet Evropian dhe transferimit të 40 të punësuarve në Ministrinë për Integritet Evropian (MIE) të sapokrijuar.

Rritja në kategorinë e pagave dhe mëditjeve nga buxheti fillestar në atë me rishikim ka ardhur si rezultat i vendimit të Qeverisë për ngritjen e pagave me shtesë individuale prej 30€. Ndërsa rritja e buxhetit final në raport me atë të rishikuar është pagesa për shujta në fund të vitit.

Në buxhetin fillestar dhe atë të rishikuar nuk janë të përfshira të hyrat vetanake dhe donacionet. Kjo ka ndikuar që të gjitha kategoritë e shpenzimeve të kenë ngritje me buxhetin final. Po ashtu me vendime të caktuara të ZKM-së ka ngritje në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve si dhe të investimeve kapitale.

Nëse i krahasojmë shpenzimet me buxhetin final sipas kategorive ekonomike, vërejmë që realizimi më i ulët i shpenzimeve ishte në kategorinë e investimeve kapitale 80% e buxhetit final. Megjithatë, kemi vërejtur se buxheti i ZKM-së ishte shpenzuar në përputhje me projektet e parapara dhe në propocion me planet kohore. Kjo tregon se ZKM kishte parandaluar mundësinë e akumulimit të shpenzimeve në muajt e fundit të vitit.

Konkluzion

Nga kjo mund të konkudojmë që ZKM-ja kishte një realizim prej 84% të buxhetit. Realizim më të ulët kishte në kategorinë e investimeve kapitale, andaj në të ardhmen duhet ti kushtohet më shumë rëndësi edhe kësaj kategorie.

V. Pasqyrat Vjetore Financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP nr. 03/L-048 dhe UA16/2010, ne kemi identifikuar pikat në vijim:

- ZKM i ka përgatitur PVF-të në pajtueshmëri me UA 16/2010;
- PVF-të janë nënshkruar nga personat përgjegjës, ZKA dhe ZKF;
- PVF-të janë dorëzuar në thesar brenda kohës ligjore me datën 30/01/2011.
- PVF-të janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- ZKM ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010; dhe
- Në PVF-të nuk është bashkangjitur edhe plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar.

Konkluzion

Në përgjithësi ZKM-ja ka përmbushur afatet ligjore në raportimin e jashtëm. PVF-të janë dorëzuar me kohë si dhe janë nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës, përveç pikës në të cilën nuk është bashkangjitur plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar në PVF.

V.2 Cilësia e informatave

Ne kemi rishikuar informatat e prezantuara në PVF-të e ZKM-së para finalizimit të tyre.

Gjatë rishikimit kemi vërejtur disa mangësi si në vijim:

- Në regjistrin kontabël të pasurive në SIMFK dhe në atë të përgjithshëm, nuk janë regjistruar disa pasuri të blera me vlerë mbi 1,000€, por dhe me vlerë më të vogël;
- Nga kategoria e investimeve kapitale në AUV, janë procesuar pagesa për shpenzime të ndryshme si: furnizime për material harxhues, shpenzime të internetit, blerje të pasurive me vlera të vogla, e të cilat nuk i përkasin kësaj kategorie të shpenzimit; dhe
- Nga gjithsejt pagesat e testuara në ZKM, në 14 raste kemi vërejtur pagesa të regjistruara në kode ekonomike joadekuate.

Konkluzion

Ne konkludojmë se mos prezantimi i duhur i pasurive e nënvlerëson vlerën reale të pasurive.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i përgjithshëm:

- Ndërmerr veprime adekuate për prezantimin e drejtë të pasurive në PVF; dhe
- Nëpërmjet personave përgjegjës të kërkoj kontrolle adekuate gjatë regjistrimit të të dhënave sipas kodeve të përcaktuara në mënyrë që PVF-të të prezantojnë gjendjen e drejtë sipas kategorive ekonomike.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në kuadër të ZKM-së për vitin 2010 janë 4,807,293€. Prej tyre 4,260,832€ janë të hyra vetanake ndërsa 546,461€ të hyra nga donacionet.

Të hyrat vetanake janë shpalosur në tabelën në vijim:

Nr	Të hyrat e realizuara	Shuma në €
1	Zyra e Kryeministrit	352,252
2	Agjencioni i Ushqimit dhe Veterinës	3,877,519
3	Arkivi i Kosovës	31,061
Totali i të hyrave		4,260,832

Të hyrat nga ZKM-ja janë realizuar nga: qiraja, gazeta zyrtare si dhe nga taksat administrative tjera. Të hyrat vetanake të mbledhura nuk mund të shfrytëzohen nga ZKM-ja, mirëpo drejtëpërdrejtë kalojnë në Buxhetin e Kosovës.

AUV, të hyrat i realizon nga: shërbimet e dezinfektimit, inspektimi fitosanitar, sanitar si dhe nga ai veterinar. Nga këto të hyra që realizon AUV, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet MEF-it dhe ZKM-së, gjatë vitit 2010, AUV mund të shfrytëzoj shumën deri në 540,800€.

Po ashtu të hyrat që AK-ja realizon përmes ofrimit të shërbimeve për dokumente arkivore si dhe ato nga qiraja, mund të shfrytëzohen deri në shumën 24,788€. Kjo ishte rregulluar duke u bazuar në marrëveshjen e cekur më lartë, ndërmjet MEF-it dhe ZKM-së.

Ne testuam të hyrat e realizuara në kuadër të ZKM-së prej fazës së faturimit e deri te faza e inkasimit të tyre. Testet tona shpalosën të gjeturën në vijim:

Inkasimi i ulët i të hyrave

ZKM i realizon të hyrat nga qiraja në vlerë mujore prej 22,000€ duke u bazuar në marrëveshjen në mes të UNMIK-ut dhe INA (industrisë së naftës). Sipas kësaj marrëveshje INA shfrytëzon pasurinë publike respektivisht objektet për depozitimin e naftës.

Po sipas saj, ZKM-ja e bënë faturimin për çdo muaj. INA është i detyruar ta përmbush obligimin brenda 45 ditëve. Në këtë rast, INA nuk i ka kryer të gjitha obligimet e parapara sipas marrëveshjes kontraktuale, duke bërë që borxhi në fund të vitit të jetë 131,928€.

Konkluzion

Të hyrat nga qiraja nuk janë mbledhur në nivelin e pritur sipas marrëveshjes kontraktuale. Kjo na bënë të kuptojmë që ZKM-ja nuk i ka përdorur të gjitha instrumentet për mbledhjen e tyre.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i përgjithshëm:

- Është duke bërë përpjekje të vazhdueshme të sigurojë që zyrtarët përgjegjës arkëtojnë mjetet e faturuara ndaj shfrytëzuesit të pasurisë publike në përputhje me marrëveshjen kontraktuale.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimit

ZKM, për vitin 2010 kishte planifikuar prokurime në vlerë prej 1,303,500€. Prej tyre kishte realizuar 1,066,095€ apo 82% e planit të prokurimit. Ne kemi testuar 12 lëndë në vlerë prej 316,085€ apo 30%, tek prokurimet e realizuara në ZKM. Përveç kësaj, ne kemi testuar edhe 7

lëndë në AUV në vlerë prej 326,728€. Në kuadër të këtyre shpenzimeve, testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Pranimi i pajisjeve jo në përputhje me kontratë

AUV ka lidhur kontratë për furnizim të pajisjeve për laboratorin e ushqimit. Sipas kësaj kontrate specifikohen karakteristikat që duhet ti përmbajnë këto pajisje.

Gjatë ekzaminimit fizik dhe raportit të pranimit të këtyre pajisjeve kemi vërejtur që 3 nga 14 prej tyre, nuk janë të njëjta me ato të kontraktuara. Kjo rritë rrezikun që të pranohen mallra të kualitetit më të dobët.

Realizimi i punimeve në AUV pa kontratë adekuate

Çdo investimi kapital fillimisht i paraprinë projekti i llojit të punimeve në të cilën parashihen paramasat dhe parallogaritë e punëve.

Gjatë testimit të pagesës në vlerë prej 34,912€ kemi vërejtur që për realizimin e punimeve në oborrin e laboratorit të gripit të shpendëve në AUV është shfrytëzuar kontrata e vazhduar për riparim dhe mirëmbajtje të pikave dezinfektuese. Çmimi i kësaj kontrate ishte për njësi dhe nuk ka qenë e kontraktuar për rregullimin e oborrit të laboratorit të gripit të shpendëve.

Mungesa e dëshmive në procedurat e prokurimit

Nga procedurat e koutimit të çmimeve në AUV për furnizim me material higjenik, kemi vërejtur se DT nuk ishte e kompletuar sipas LPP-së. Në DT mungonte procesverbali i hapjes së ofertave.

Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre operatorëve të përgjegjshëm

Në DT të çdo tenderi dhe në njoftimin për kontratë përcaktohen të gjitha kriteret e domosdoshme për të vlerësuar përgjegjshmërinë e ofertuesve që aplikojnë për kontratë.

Në katër raste, kemi vërejtur se janë përzgjedhur fituesit në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme. Këto dobësi janë vërejtur te kontratat për:

- “Mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve” të AUV-së, ku përveç fituesit OE-të tjera nuk kanë plotësuar kriterin e garancionit me shkrim për pjesët e këmbimit minimum 12 muaj;
- “Blerja e veturës në ZKM”, ku dy nga OE-të tjera nuk kanë plotësuar specifikacionin teknik të DT-së me elementet e kërkuara;
- “Kontrolli i qenëve endacak” në AUV, ku nga katër OE-të konkurrues, vetëm fituesi i tenderit ka qenë i përgjegjshëm. Asnjëri nga OE-të tjerë nuk i kanë dorëzuar dëshmitë e mjaftueshme mbi kushtet e punës, të kërkuara në DT; dhe
- “Servisimi i veturës BMW në ZKM”, ku OE fitues nuk ka ofruar deklaratën e ATK-së që nuk është në vonesë për pagesën e tatimeve. Në vend të sajë ka ofruar një ankesë ndaj një vendimi të ATK-së.

Mospërputhje midis çmimeve në faturë dhe kontratë

Çdo marrëveshje kontraktuale ndërmjet AK-së dhe OE-së kanë të determinuara të gjitha kushtet, karakteristikat dhe çmimet e shërbimeve.

Në tri raste në AUV, kemi vërejtur pagesa për shërbimet e kryera që nuk janë në përputhje me ato të kontraktuara. Megjithatë, këto çështje nuk janë aq materiale.

Ekzekutimi i pagesës pa poseduar dokumente përkatëse

Për iniciimin dhe realizimin e pagesës së një shërbimi të kryer, i cili ka kaluar përmes procedurave të prokurimit, duhet që paraprakisht të ketë dokumentet përkatëse që arsyeton shërbimin në fjalë.

Gjatë testimit të lëndës për anagazhimin e konsulentit/trajnerit ndërkombëtar në Agjencionin për Barazi Gjinore (ABGJ), kemi vërejtur që janë bërë pagesa në vlerë prej 1.048€ për secilin prej dy trajnerëve të kontraktuar pa poseduar dokumentet përkatëse mbi trajnimet e mbajtura, si p.sh. një raport i plotë i orëve të mbajtura. Po ashtu, data e biletës së udhëtimit nuk përkon me kohën e trajnimit.

Kjo do të thotë se është bërë ekzekutimi i pagesës pa dëshmi për përmbushjen e kontratës nga trajnerët. Po ashtu datat e këtyre pagesave nuk përkojnë me datat kur janë parashikuar të mbahen trajnimet në fjalë dhe me periudhën e kontratës.

Procesimi i urdhërblerjes pa nënshkrimin e menaxherit të prokurimit

Për të realizuar pagesën e një shërbimi të kryer, i cili ka kaluar përmes procedurave të prokurimit, duhet që urdhëri për blerje të jetë i nënshkruar nga menaxheri i prokurimit si përgjegjës për përmbushjen e kontratës.

Tek lënda për kursin e gjuhës angleze në ABGJ, kemi hasur në urdhërblerje të nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv i ABGJ-së dhe jo nga menaxheri i prokurimit i cili ka nënshkruar kontratën për ZKM-në. Kjo kontratë e lidhur me ZKM-në, është shfrytëzuar nga ABGJ-ja për shërbimet e kursit të gjuhës angleze.

Konkluzion

Në menaxhimin e prokurimeve ka dobësi duke filluar prej fazës së iniciimit e deri në fazën e ekzekutimit të kontratave. Në bazë të kësaj kuptojmë që edhe më tutje kontrolli mbi sistemin e prokurimit nuk është tërësisht funksional.

Po ashtu kontrolli i brendshëm i pagesave nuk ka arritur të parandalojë gabimet e paraqitura, si pagesa jo në përputhje me kontratë ose të pa kontraktuara.

Kjo mund të dërgoj deri te një situatë ku blerjet, përkundër vlerës së parasë së dhënë të mos jenë të kualitetit të duhur. Njëherit, ZKM-ja ka rrezikuar që realizimi i projekteve të mos bëhet sipas kushteve dhe afateve të kontraktuara.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Analizon proceset aktuale të prokurimit dhe kontrollit të brendshëm, në veçanti në agjencionet e pavarura. Më tej, duhet të kërkojë përgjegjësi nga menaxherët e këtyre agjencive;
- T'i kushtoj vëmendje të veçantë LPP-së dhe që Urdhëri për Blerje të jetë i nënshkruar nga Menaxheri i Prokurimit; si dhe
- Aplikon kontrole të cilat sigurojnë se mallrat dhe shërbimet pranohen në pajtim me kushtet e kontratës.

2.2 Blerjet tjera

Në kategorinë e blerjeve tjera janë përfshirë të gjitha blerjet për mallra dhe shërbime, për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit.

Gjatë testimeve tona për këtë kategori të shpenzimeve, ne nuk kemi vërejtur ndonjë dobësi që do të vlente për tu theksuar në këtë raport.

2.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Numri i të punësuarve në ZKM deri në Maj të vitit 2010, përfshirë edhe Agjensionin për Integritet Evropian sipas listës së pagave ishte gjithsej 499. Pas kalimit të këtij të fundit në Ministri për Integritet Evropian (MIE), nga muaji Qershor deri në Dhjetor numri i të punësuarve në ZKM ishte 460.

Shpenzimet totale për paga dhe mëditje për vitin 2010 ishin 2,338,439€. Prej tyre nga lista e pagave janë 2,317,327€, ndërsa përmes donacioneve janë 21,112€.

Testimet tona të dosjeve të personelit kanë shpalosur dobësi në:

Mos azhurnimi i dosjeve të personelit me kohë

Gjatë testimit të dosjeve të personelit në ZKM, kemi vërejtur se në disa raste dosjet e personelit në ZKM, për të cilat kishte ndryshime (si: përgatitja profesionale, përvoja, trajnimet e stafit gjatë vitit, etj.) nuk janë kompletuar dhe azhurnuar me kohë.

Konkluzion

Përveç azhurnimit jo të mirë në disa raste të dosjeve të personelit, ZKM-ja kishte vendosur kontroll të mirë në departamentin e resurseve njerëzore.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ndërmerr veprime që të siguroj se dosjet e personelit janë duke u kompletuar dhe azhurnuar me kohë.

2.4 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet dhe transferet gjatë vitit 2010 ishin 1,118,311€, apo 11.8% e buxhetit të ZKM-së. Kjo vlerë paraqet ndihmën financiare që ZKM-ja ka ofruar për entitetet publike dhe jo publike, financimin e projekteve kulturore, ndihmë për invalid, familje të dëshmorëve, për komunitete dhe organizata joqeveritare (OJQ-të).

Mungesa e politikave dhe kriterëve për dhënien e subvencioneve

Nga auditimi i subvencioneve dhe transfereve kemi vërejtur se ZKM-ja me rastin e dhënies së subvencioneve në disa raste nuk ka përcaktuar marrëveshje të qarta për mënyrën e dhënies dhe shfrytëzimit të subvencioneve.

Në kuadër të menaxhimit të subvencioneve, ZKM në katër raste nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për mënyrën se si janë shfrytëzuar këto subvencione. Shuma e këtyre subvencioneve arrinë vlerën 53,184€.

Konkluzion

Si rezultat i kontrollit jo të mirë në menaxhimin e subvencioneve, veçanërisht tek dhënia e tyre nuk janë kërkuar të dhëna të mjaftueshme sa i përket mënyrës, formës dhe shfrytëzimit të subvencioneve.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Kërkon aplikimin e procedurave të qarta, si dhe vendosjen e kriterëve matëse në fushën e subvencioneve; dhe
- Kërkon kontrolle më të mira të brendshme bazuar në marrëveshjet lidhur me shfrytëzimin dhe raportimin për subvencionet e dhëna.

2.5 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Lista e pasurive të ZKM-së e marrë nga thesari përmban një vlerë neto të pasurive prej 4,063,662€. Ne kemi testuar 12 fatura (në vlerë prej 375,420€) të pasurive të cilat janë blerë gjatë vitit duke u bazuar njëkohësisht edhe në listën e pasurive nën 1,000€.

Përkundër rekomandimit të dhënë nga auditimi i vitit të kaluar lidhur me menaxhimin e pasurisë, ZKM nuk ka arritur ende të menaxhojë në mënyrë efikase pasuritë e saj. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Mos regjistrimi i pasurive me vlerë mbi 1,000€ në SIMFK

Sipas U.A. Nr.21/2009 për 'Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare' çdo blerje e pasurisë me vlerë mbi 1,000€ duhet të regjistrohet në regjistrin kontabël të pasurisë, përkatësisht në SIMFK.

Gjatë auditimit të këtyre pasurive në dy raste kemi konstatuar që pasuritë nuk janë regjistruar në SIMFK si në vijim:

- Fotokopja me vlerë prej 5,968€ e blerë nga AIE; dhe
- Programi softuerik në vlerë 36,425€ nga AUV.

Kjo ka ndodhur për arsye të neglizhencës nga ana e zyrtarit për pasuri në AUV dhe AIE.

Si rezultat i kësaj kemi një prezentim jo të saktë të gjendjes së pasurive të raportuara nga SIMFK për pasuritë e ZKM-së, përkatësisht nga AUV dhe AIE në PVF.

Mos evidentimi i pasurive në regjistrin e përgjithshëm

Gjatë testimit në tre raste (dy në AUV dhe një në ZKM), kemi vërejtur që pasuritë e pranuar dhe të paguara nuk janë evidentuar në regjistrin e përgjithshëm të pasurive.

Po ashtu gjatë procesit të shpërndarjes në AUV kemi vërejtur një listë të punonjësve të cilët kanë përfituar artikujt në fjalë, por që nuk janë nënshkruar dhe ngarkuar për pranimin e tyre.

Konkluzion

Mungesa e regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël, përkatësisht në SIMFK ashtu edhe në regjistrin e përgjithshëm të pasurisë është si rezultat i kontrollit dhe menaxhimit jo të mirë të pasurisë. Si rrjedhojë pasuritë e ZKM-së nuk janë të prezantuara drejtë në PVF. Kjo mund të ketë për pasojë humbjen apo keq menaxhimin e pasurive.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Forcon mbikëqyrjen e procesit të regjistrimit të pasurive me vlerë mbi 1,000€ në SIMFK dhe në regjistrin e përgjithshëm brenda ZKM-së dhe të gjitha agjencionet që operojnë brenda saj; si dhe
- Kërkon nga menaxherët e Agjencive që përmes zyrtarëve përgjegjës të bëjnë pranim/ngarkimin me dokumente mbështetëse për të gjitha pasuritë në shfrytëzim.

2.6 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte në vlerë prej 281,056€ (këtu janë përfshirë edhe obligimet e agjencioneve). Pjesa më e madhe e obligimeve në vlerë prej 171,579€ janë nga administrata e ZKM-së.

Në bazë të faturave të prezentuara në PVF si obligime të bartura, vërejmë që shumica e tyre janë në tremujorin e fundit të vitit. Mirëpo në disa raste kemi fatura që janë pranuar në muajin Qershor, Korrik etj, e të cilat nuk janë proceduar me kohë për pagesë.

Konkluzion

Edhe përkundër faktit se shumica e faturave janë pranuar në muajin Dhjetor, kjo nuk e arsyeton plotësisht rritjen e obligimeve, pasi që në disa raste nuk është arritur të përcjellen me kohë për pagesë faturat e pranuar.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ndërmerr masa që të gjitha faturat e pranuar janë paguar në përputhje me afatet e pagesave në mënyrë që të evitohen detyrimet.

VII.Menaxhimi i kontrollit

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike. Kjo do të siguronte raportim të besueshëm financiar.

ZKM ka një sistem të kontrollit të brendshëm. Sidoqoftë, testimi thelbësor ka shpalosur dobësi në funksionimin e tij. Këto dobësi kanë të bëjnë me:

- Menaxhimin e prokurimit brenda ZKM-së dhe AUV-së;
- Menaxhimin e pasurive në ZKM dhe në veçanti në AUV;
- Procesimin e pagesave në kode ekonomike jo adekuate në ZKM dhe AUV;
- Menaxhimin e të hyrave nga ZKM;
- Menaxhimin e subvencioneve nga ana e ZKM-së;
- Ekzekutimin e pagesave jo në përputhje me kontratë në AUV ;
- Ndarjen e detyrave më të mirë (zyrtari i pasurisë në AUV ushtronte edhe funksionin e zyrtarit të pranimit, që në realitet paraqet konflikt interesi); dhe

- Nënshkrimi i urdhër blerjes nga personat jo përgjegjës në ABGJ.

Konkluzion

Duke u bazuar në të gjeturat e prezantuara, vijmë në konkludim që si rezultat i funksionimit jo të mirë të kontrollit të brendshëm, ZKM-ja nuk ka arritur që të parandalojë apo detektojë të gjitha gabimet dhe parregullsitë e mundshme. Kjo mund të rezultojë me menaxhim jo të mirë të shpenzimit të parasë publike.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Ka shtuar përpjekjet për përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm duke eliminuar të gjitha dobësitë që e përcjellin.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Në Planin vjetor të auditimit për vitin 2010, auditori i brendshëm (AB) kishte planifikuar pesë (5) auditime. Këtë përcaktim e kishte bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Gjatë periudhës në të cilën ne kemi audituar, AB kishte kryer tri auditime, për të cilat kishte dhënë rekomandime me qëllim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm. Ndërsa ishte në proces të auditimit edhe në dy të tjera.

Në kuadër të ZKM-së është i themeluar edhe Komiteti i Auditimit i cili gjatë vitit për të cilin ne kemi audituar nuk kishte mbajtur asnjë takim.

Konkluzion

Megjithatë mbetet sfidë e menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit të siguroj që rekomandimet e NJAB-së janë duke u adresuar dhe për to janë ndërmarrë masa adekuate.

Rekomandimi 10

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Kërkon mbajtjen e takimeve të rregullta gjatë vitit nga Komiteti i Auditimit për të analizuar dhe adresuar më mirë rekomandimet e auditimit.

VIII. Konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e ZKM-së

Bazuar në të gjeturat dhe konkluzionet e këtij raporti vijmë në konkludimin e përgjithshëm se menaxhmenti i ZKM-së kishte një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm. Mirëpo, edhe përkundër këtij faktit, ZKM nuk kishte arritur që përmes mekanizmave të tij të siguroj një funksionim të mirë të kontrollit në eliminimin e dobësive.

Në kuadër të cilësisë së informatave të raportuara në PVF, kemi vërejtur disa gabime gjatë regjistrimit të shpenzimeve nëpër kodet ekonomike jo adekuate.

Për të hyrat, ZKM-ja nuk kishte arritur që përmes mekanizmave të saj të siguroj inkasim të kënaqshëm në raport me atë që ka faturuar gjatë vitit.

Menaxhimi i procedurave të prokurimit nuk ishte bërë në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore. Kontrolli financiar nuk kishte arritur të parandaloj gabimet dhe parregullsitë e paraqitura në pagesa.

Po ashtu nuk kishte evidenca të plota për pasuritë e saj, konkretisht blerjet e pasurisë nuk janë regjistruar me kohë.

Duke u bazuar në konkluzionin e përgjithshëm rekomandojmë ZKM-në si në vijim.

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Kryeministrin të siguroj që Sekretari i Përgjithshëm:

- Do të rishikoj dhe të analizoj sistemin ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të funksionalizoj llogaridhënien dhe përgjegjësinë në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara; dhe
- Në kordinim me menaxherët e agjencive (AUV dhe ABGJ), ndërmarrin veprime konkrete për adresimin e rekomandimeve të dhëna.

Shtojca I. Komentet e ZKM-së dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të ZKM-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit për vitin 2010 dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; dhe
- (d) është një shpallje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalljeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinion i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.